



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E SHËNDETËSISË DHE E MBROJTJES SOCIALE
SPITALI RAJONAL ELBASAN

Data 15 .01.2025

PROCESVERBAL – Tipi i kontratës - Mall

**PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE
KRITEREVE PËR KUALIFIKIM**

(Ky procesverbal është për efekt publikimi bashkë me dokumentet e tenderit)

OBJEKTI I PROCEDURËS:

“Blerje Materiale Mjekimi” Marreveshje kuader me nje operator ekonomik ku te gjitha kushtet jane te percaktuara me afat 12 muaj

KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (CPV):

33140000-3 Materiale mjekesore te konsumueshme

Fondi limit/ Vlera e pritshme e kontratave : 29,709,931.02 (njetzet e nente milion e shtatëqind e nente mije e nëntëqind e tridhjetë e një presje zero dy) leke pa TVSH

ose 302,483.5 (treqind e dymije e katerqind e tetedhjetë e tre presje pese) EURO pa TVSH.
Kursi i këmbimit sipas Bankës së Shqipërisë date 16.01.2025 është 98.22 lekë.

Ndare ne Lote

Loti 1 – Blerje materiale mjekimi per nevoja spitalore

Fondi limit/Vlera e pritshme e kontratave – 12,867,203.35 (dymbëdhjetëmilion e tetwqind e gjashtwdhjetw e shtatwmijw e dyqind e tre prejse tridhjetw e pesw) leke pa tvsh

ose 131,004 (njqind e tridhjetë e njemije e kater) EURO pa TVSH. Kursi i këmbimit sipas Bankës së Shqipërisë date 16.01.2025 është 98.22 lekë.

Loti 2 – Blerje materiale mjekimi konsumi dhe kirurgjikale per nevoja spitalore

Fondi limit/Vlera e pritshme e kontratave – 16,842,727.67 (*gjashtwmbwdhjetwmilion e tetwqind e dyzet e dymijw e shtatwqind e njwzet e shtatw presje gjashtwdhjetw e shtatw*) leke pa tvsh ose 171,479.6 (njqind e shtatedhjete e njemije e katerqind e shtatedhjete e nente presje gjashte) EURO pa TVSH. Kursi i këmbimit sipas Bankës së Shqipërisë date 16.01.2025 është 98.22 lekë

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021“Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”,autoriteti/enti kontraktor Spitali Rajonal Elbasan ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Kandidati/ofertuesi duhet të dorëzojë:

a.Formularin e Ofertës, sipas Shtojcës 1

b.Lista e cmimeve të artikujve, sipas shtojcës 2

c.Formularin Permbledhes të Vetedeklarimit, sipas shtojcës 8

ç.Sigurimin e ofertes, sipas Shtojcës 3 vlerën e kërkuar të sigurimit të ofertës, e cila duhet të jetë 2% e vlerës së përlllogaritur lotit.

Argumentimi: Kërkesat e mësipërme bazohen në nenet 76, 82 dhe 83 të LPP, nenit 26, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

2.2. Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

2.2.1 Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetim për xhiron vjetore për vitet financiare 2020, 2021, 2022, ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë jo më e vogël se 40% e fondit limit/ të lotit apo shumës së loteve për të cilat oferton (Kjo kërkesë do të konsiderohet e përmbushur nëse Operatori ekonomik arrin vlerën e xhiros minimale në të paktën një vit të periudhës së kërkuar nga Autoriteti Kontraktor).

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në vlerën e fondit limit të kësaj procedure, si dhe bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 43, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar argumentohet si më poshtë:

Bazuar në nenin 43 pika 2/b, 43 pika 3 dhe 43 pika 5 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, te ndryshuar, ku përcaktohet:

Neni 43 pika 2/b

Vlera e xhiros minimale vjetore që u kërkohet operatorëve ekonomikë nuk mund të tejkalojë:

b) vlerën e përlllogaritur të kontratës ose lotit , në procedurat e prokurimit ndërmjet kufirit të lartë dhe të ulët monetar;

Neni 43 pika 3

Kërkesa për plotësimin e kapaciteteve financiare konsiderohet e përmbushur nëse operatorët ekonomikë arrijnë vlerën e xhiros minimale, në të paktën një vit të periudhës së kërkuar nga autoriteti/enti kontraktor.

Neni 43 pika 5

Në rastin e kontratave që bazohen në një marrëveshje kuadër, kërkesa për xhiron minimale, llogaritet mbi bazën e vlerës maksimale të kontratave specifike që do të zbatohen në të njëjtën kohë ose, kur përmasat nuk dihen, mbi bazën e vlerës së parashikuar të marrëveshjes kuadër.

Shënim: Duke qenë se aktet ligjore dhe nënligjore parashikojnë një marzh për vlerën e xhiros që mund të kërkohet, autoritetet/entet kontraktore duhet të argumentojnë vlerën e kërkuar të xhiros brenda këtij marzhi.

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë bazuar në nenin 29, te Ligjit Nr. 8438, dt. 28.12.1998 "Për Tatimin mbi të Ardhurat", i ndryshuar, ku përcaktohet: *Çdo tatimpagues pergatit deklaratën vjetore të ardhurave të tatueshme në formën e përcaktuar në udhëzimin e Ministrisë të Financave në zbatim të këtij ligji. Tatimpaguesit paraqesin deklaratën vjetore në organet tatimore brenda dates 31 mars të vitit pasardhës.*

Vlerësojmë se vërtetimin për xhiron vjetore të certifikuar të vitit 2021, operatorët ekonomikë mund ta disponojnë pas paraqitjes së deklaratës vjetore në organet tatimore, për të cilën kanë afat deri më 31.03.2022.

(Shënim: citoni dispozitën përkatëse të legjislacionit tatimor, ku përcaktohen afatet për paraqitjen nga tatimpaguesit të deklaratës vjetore pranë organeve tatimore).

2.3 Aftësitë teknike dhe profesionale:

2.3.1 Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për shërbimet e mëparshme të ngjashme, të kryera gjatë tre viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, në një vlerë jo më të vogël se 20% e vlerës së përlllogaritur të fondit *per secilin prej loteve / shumatores se loteve per te cilat konkurron*

Për të vërtetuar përvojën e mëparshme të ngjashme, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dëshmitë e mëposhtme:

- a) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin publik, operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës,

ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës, ose/dhe faturave tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, ku shënohen datat, shumat **dhe mallrave të furnizuara**

- b) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin privat, operatori ekonomik duhet të paraqesë fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat **dhe mallrave të furnizuara**.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 40, pika 4, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që furnizimet e mëparshme të ngjashme të jenë në vlerën jo më pak se .40% të vlerës së fondit limit të lotit që oferton, vlerë e cila është brenda vlerës kufi të përcaktuar në nenin e sipërcituar.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar për kontratat e ngjashme argumentohet si më poshtë dhe është në përputhje me përcaktimet e RRPP neni 40 pika 4:

“4. Për të provuar përvojën e mëparshme, autoriteti/enti kontraktor kërkon dëshmi për realizimin me sukses të një ose disa kontratave të mëparshme, të ngjashme, të kryera gjatë tre viteve të fundit. Në çdo rast, vlera totale e kërkuar duhet të jetë në një vlerë jo më të madhe se 40% të vlerës së përllogaritur të kontratës, që prokurohet dhe që është realizuar gjatë tre viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës.

Autoriteti/enti kontraktor si dëshmi për përvojën e mëparshme kërkon vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës ose/dhe fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.

Në rastin e përvojës së mëparshme të realizuar me sektorin privat, si dëshmi pranohen vetëm fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.”

Është kërkuar që furnizimet e mëparshme të ngjashme të jenë në vlerën **sa 40% të fondit limit/(të lotit apo shumës së loteve për të cilat oferton operatori**, që është brenda vlerës kufi të përcaktuar në nenin e sipërcituar (jo më të madhe se 40% të vlerës së përllogaritur të kontratës).

Shënim: Duke qenë se aktet ligjore dhe nënligjore parashikojnë një marzh për vlerën e kontratave të ngjashme që mund të kërkohet, autoritete/entet kontraktore duhet të argumentojnë vlerën e kërkuar të kontratave të ngjashme brenda këtij marzhi.

2.3.2 Operatori ekonomik duhet të vetëdeklarojë origjinën e mallit dhe kompaninë prodhuese, kjo të plotësohet në Shtojcën 2. Lista e Çmimeve të artikujve të DST.

Argumentimi: Ky kriter vendoset me qëllim njohjen e origjinës së mallit dhe kompaninë prodhuese për të identifikuar në mënyrë të qartë atë gjatë lëvrimit të tij dhe për të pasur sigurinë që i njëjti mall i ofertuar do të lëvrohet në destinacion ne perputhje me nenin 40, pika 8, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, dhe keto kërkesa i shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e mundësisë së OE për përmbushjen me sukses te kontrates pra te garancise se furnizimit te mallit objekt prokurimi.

2.3.3 Operatori ekonomik ofertues duhet të paraqese certifikimin **ISO 9001:2015** mbi “**Sistemet e menaxhimit të cilësisë**”, në përputhje me objektin e prokurimit, lëshuar nga nje organ i vleresimit te konformitetit, i akredituar nga organizmi kombetar i akreditimit ose nga organizma nderkombetare akreditues, te njohur nga Republika e Shqiperise. Çertifikata duhet të jetë e vlefshme në kohën e zhvillimit të tenderit

2.3.4. Operatori ekonomik ofertues duhet të paraqese certifikimin **ISO 13485:2016** “**Sistemi i Menaxhimit të Cilësisë për Pajisjet Mjekësore**” ose **ekuivalent**, të prodhuesit, në përputhje me objektin e prokurimit, lëshuar nga nje organ i vleresimit te konformitetit, i akredituar nga organizmi kombetar i akreditimit ose nga organizma nderkombetare akreditues, te njohur nga Republika e Shqiperise. Çertifikata duhet të jetë e vlefshme në kohën e zhvillimit të tenderit.

Argumentimi: Ky kriter i percaktuar ne piken b) dhe c) eshte vendosur ne perputhje me piken 1 te nenit 79 te Ligjit nr.162/2020”Per Prokurimin Publik”, ne te cilen gjejme te percaktuar se:

Ky kriter gjen mbeshtetje ne piken 1 te nenit 44 te VKM nr 285 date 19.05.2021 “Per Miratimin e Rregullave te Prokurimit Publik”ku percaktohet se: *1. Autoriteti/enti kontraktor, për të vërtetuar se punët, mallrat ose shërbimet, object prokurimi, I plotësojnë kërkesat e cilësisë, mund t’u kërkojë ofertuesve të paraqesin certifikata të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë, vetëm nëse ato janë të argumentuara dhe të lidhura ngushtësisht dhe nëmënyrë të drejtpërdrejtë me objektin e prokurimit.*

Gjithashtu ky kriter gjen mbeshtetje dhe ne rekomandimin e APP dhe Drejtorise se pergjithshme te Akreditimit nr. 3330 prot, date 20.03.2018 dhe nr. 145 prot, date 16.03.2018 “Rekomandim mbi hartimin e kërkesave te cilesise”.

Autoriteti kontraktor Spitali Rajonal Elbasan kërkon nga ofertuesit përmbushjen e kriterëve të mësipërme për të vërtetuar se artikujt/materialiet mjekësore objekt prokurimi kanë ndjekur një proces rigoroz prodhimi, duke patur në konsideratë konsumatorin fundor, efektivitetin e artikullit/materialit mjekësor, si dhe aftësinë për të prodhuar, ruajtur dhe ofrimin e asistencës për përdorimin e këtyre materialeve

AK gjykon se kërkesa për pajisjen e Ofertuesve me Çertifikatat e kërkuar është brenda kuadrit të parashikuar nga legjislacioni për prokurimin publik. Çertifikatat e kërkuara janë në përpjestim

me objektin e kontratës. *Duke parë objektin e prokurimit, autoriteti kontraktor vlerëson të nevojshme të kërkojë që operatorët ekonomikë ofertues të jenë të pajisur me certifikata të cilësisë në përputhje me objektin e prokurimit, me qëllim që furnizimet të kryhen me cilësi sipas certifikatave ISO të mësipërme.*

2.3.5 Operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë **autorizim nga firma prodhuese / MAH / distributori i autorizuar**, (ku të provohet/dokumentohet lidhja e tyre me prodhuesin) **per tregtimin e mallrave objekt prokurimi**. Autorizimi duhet të jetë origjinal dhe nëse nuk është në gjuhën angleze ose shqipe, të përkthehet në gjuhën angleze ose shqipe dhe të noterizohet.

Ne rastin e distributorit te autorizuar per Shqiperine te provohet lidhja me prodhuesin nepermjet dokumentacionit perkates

Argumentimi: Ky kriter gjen mbeshtetje ne pikat 2 dhe 4 te nenin 77 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe piken 5 te nenit 44 të VKM nr 285 date 19.05.2021 “Per Miratimin e Rregullave te Prokurimit Publik”, ku eshte e cituar: *5. Kur është e dukshme që një operator ekonomik e ka të pamundur të marrë etiketën specifike, të cilësuar nga autoriteti/enti kontraktor ose një etiketë ekuivalente, brenda afateve kohore përkatëse, për shkaqe që nuk lidhen me atë operator ekonomik, autoriteti ose enti kontraktor pranon mënyra të tjera vërtetimi të përshtatshme, që mund të përfshijnë një dosje teknike nga prodhuesi, nëse operatori ekonomik në fjalë vërteton se punët, furnizimet ose shërbimet që ai duhet të ofrojë përmbushin kërkesat e etiketës specifike ose kërkesat specifike të cilësuar nga autoriteti/enti kontraktor.*

Autorizimi per OE ofertues nga firma prodhuese ose nga distributor I autorizuar prej prodhuesit është një document i domosdoshëm për t’u paraqitur, në mënyrë që autoriteti kontraktor të sigurohet që subjekti/shoqëria që disponon këtë dokument, autorizon operatorin ekonomik që ta furnizojë me produktet e tij; domosdoshmëria e tij lidhet me garancinë e mallit të cilën e jep prodhuesi dhe jo operatori ekonomik ofertues .

Autorizimi i prodhuesit është i vetmi dokument i cili mund t’i deshmojë autoritetit kontraktor lidhjen e ofertuesit me një distributor te autorizuar apo drejtperdrejt me prodhuesin e materialeve te ofruara

2.3.6 Kerkohet **Autodeklaratë** për materialet mjekesore nga ofertuesi (distributori / prodhuesi) per konformitetin me normat MDD 93/42/EEC (sipas aplikimit të vlefshmërisë), ose EU Regulation 2017/745 ose 98/79/EC (sipas aplikimit të vlefshmërisë) ose 98/34 EC (sipas aplikimit të vlefshmërisë), bashkëlidhur me kopjet e certifikatave përkatëse FDA ose CE/DC (Deklaratë Konformiteti) kur është e aplikueshme, sipas Direktivave dhe klasifikimit të Këshillit të Europës, origjinale ose fotokopje dhe nëse nuk janë në gjuhën angleze ose shqipe, të përkthehen në gjuhën angleze ose shqipe dhe të noterizohen.

Argumentimi: Ky kriter i përcaktuar në pikën c) është vendosur në përputhje me pikën 1 të nenit 79 të Ligjit nr.162, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik”, në të cilën gjejmë të përcaktuar se: *1. Autoriteti ose enti kontraktor për të vërtetuar se punët, mallrat ose shërbimet, objekt prokurimi, i plotësojnë kërkesat e cilësisë, mund t’u kërkojë ofertuesve të paraqesin certifikata të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë. Kjo dispozitë zbatohet edhe kur kërkesat teknike u referohen kualifikimeve të kandidatit ose të ofertuesit.*

Ky kriter gjen mbështetje në pikën 1 të nenit 44 të VKM nr 285 datë 19.05.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, ku përcaktohet se: *Autoriteti/enti kontraktor, për të vërtetuar se punët, mallrat ose shërbimet, objekt prokurimi, i plotësojnë kërkesat e cilësisë, mund t’u kërkojë ofertuesve të paraqesin certifikata të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë, vetëm nëse ato janë të argumentuara dhe të lidhura ngushtësisht dhe në mënyrë të drejtpërdrejtë me objektin e prokurimit.*

Gjithashtu ky kriter gjen mbështetje në rekomandimin e APP nr. 3341/1 prot, datë 20.03.2018 “Mbi hartimin e kriterëve për kualifikim në dokumentat e tenderit të procedurave të prokurimit publik”, rekomandimin e APP dhe Drejtorisë së përgjithshme të Akreditimit nr. 3330 prot, datë 20.03.2018 dhe nr.145 prot, datë 16.03.2018 “Rekomandim mbi hartimin e kërkesave të cilësisë. Autoriteti kontraktor kërkon konformitet me direktivat (si MDD 93/42/eec, MDD 93/42/eec ...;) dhe rregulloret e BE (si Rregullorja 745/2017/EU), për t’u siguruar se materialet / mjekësore që do të ofertohen nga operatori ekonomik i suksesshëm janë prodhuar dhe vendosur në treg në përputhje me rregullat e cilësisë, të përcaktuara në këto akte. Në këtë mënyrë, gjykojmë se përcaktimet konkrete të akteve ligjore të Bashkimit Evropian nuk përbëjnë pengesë për OE të interesuar, duke marrë parasysh se këta të fundit janë të detyruar të ofertojnë mallra që janë prodhuar / vendosur në treg duke përmbushur standardet më të larta, kjo duke u bazuar edhe në faktin, se kjo praktikë e ndjekur ndër vite nga AK, veprimtaria e të cilës ka të bëjë drejtpërdrejt ose në mënyrë indirekte me jetën e pacientit, ka rezultuar e suksesshme.

2.3.7 Operatori ekonomik duhet të paraqesë Autorizim të vlefshëm të lëshuar nga Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale në fushën e objektit të prokurimit. *(e vlefshme vetëm për OE lokalë/vendas)*

Argumentim: Ky kriter vihet në përputhje me nenin 21 “Autorizimi për tregtim të pajisjeve mjekësore” i Ligjit 89/2014 “Për pajisjet mjekësore”.

2.3.8 Kërkohen të paraqiten katalogë teknikë për të gjithë artikujt e ofertuar ku të jenë të pasqyruara specifikimet teknike të kërkuara për secilin artikull. Në katalogë, duhet të shenohet sipas numrit të artikullit në Shtojcën 2. Lista e Çmimeve të artikujve dhe të markohen me ngjyrë

të ndezur (të verdhë/kuqe), artikujt e ofruar. (Katalogët duhet të ngarkohen në ëëë.app.gov.al së bashku me dokumentacionin e **kërkuar në këto DT. Përshkrimi teknik duhet të jetë në gjuhën shqip ose anglisht**)

Argumentimi: Ky kriter është në përputhje me nenin 36 dhe 77 të Ligjit nr. 162, datë 23.12.2020, “Për Prokurimin Publik”, si dhe me piken 6/b të nenit 40 të VKM nr 285 datë 19.05.2021 “Per Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, në të cilën është e përcaktuar se: [...] 6. *Autoriteti/enti kontraktor mund t’u kërkojë operatorëve ekonomikë të dorëzojnë dëshmi, që tregojnë se ata i plotësojnë kërkesat minimale, të përcaktuara në dokumentet e tenderit, si: [...] b. fotografitë apo katalogët teknikë; [...].*

Paraqitja e katalogjeve për të gjithë artikujt që janë objekt prokurimi, është kërkuar me qëllim verifikimin e përputhshmërisë së paisjeve mjekesore që operatori ekonomik oferton, me specifikimet teknike të përcaktuara në DST në Shtojcën përkatëse

2.3.9 Operatori ekonomik duhet të paraqesë **oferten teknike** për artikujt e kërkuar, në formë tabele, ku të plotësohet: Specifikimet teknike, Emri i kompanisë prodhuese, Origjina e mallit, Skadencia e mallit, Emertimi i katalogut të artikullit/ produktit, Nr. e faqes ku ndodhet produkti, Numri i referencës së artikullit (kodi) nxjerre nga katalogu i prodhuesit, si dhe certifikimet përkatëse për produktet.

Argumentimi: Ky kriter është vendosur nga anetari i Njesisë së Prokurimit që ka specialitet përkatës në lidhje me kriteret teknike si dhe është në përputhje me **piken 1 të nenit 36 të Ligjit nr. 162, datë 23.12.2020, “Për Prokurimin Publik”**, në të cilën është e përcaktuar se:

1. Specifikimet teknike, siç përcaktohen në nenin 4 të këtij ligji, duhet të përshkruhen në dokumentet e tenderit. Në specifikimet teknike përcaktohen qartë karakteristikat e punëve, shërbimit ose furnizimit që do të prokurohen.

Këto karakteristika mund të lidhen edhe me procesin specifik ose metodën e prodhimit ose ofrimit të punëve, furnizimeve ose shërbimeve të kërkuara ose me një proces specifik për një fazë tjetër të ciklit jetësor edhe kur këta faktorë nuk përbëjnë përmbajtjen e saj thelbësore nëse ato janë të lidhura me objektin e kontratës dhe proporcionale me vlerën dhe objektivat e saj.

Në specifikimet teknike mund të specifikohet edhe nëse do të jetë i nevojshëm transferimi i të drejtave të pronësisë intelektuale.

Specifikimet teknike, me përjashtim të rasteve të justifikuara plotësisht, hartohen në mënyrë të tillë që të marrin në konsideratë kriteret e aksesueshmërisë për personat me aftësi të kufizuara ose projektimit për të gjithë përdoruesit, sipas kërkesave në legjislacionin në fuqi..

Gjithashtu ky kriter është në përputhje me piken 2 të nenit 40 të VKM nr 285 datë 19.05.2021 “Per Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, ku përcaktohet se: 2. *Për mallrat që do të prokurohen, autoritetet/entet kontraktore parashikojnë specifikimet teknike, të cilat duhet të përshkruajnë minimumin ose tërësinë e elementeve më të rëndësishme përbërëse, që garantojnë*

cilësinë e kërkuar, në përputhje me nenin 36, të LPP-së, dhe që i vlerëson mallrat si të pranueshme për funksionet e kërkuara.

Ne kete kontekst është e kërkuar dhe oferta teknike, me ane te se ciles do te behet e mundur verifikimi me i sakte i artikujve te ofertuar, specifikimeve te tyre, origjina, konformiteti etj me dokumentacionin mbështetes te paraqitur nga ofertuesi.

Sa me siper, anëtarët e njësisë se prokurimit duke u nisur edhe nga specializimet qe kanë, shqyrtuan dhe miratuan kriteret e përgjithshme dhe te veçanta te pranim kualifikimit në mbështetje te ligjit nr. nr.162 dt.23.11.2020 “Per Prokurimin Publik”i ndryshuar, VKM nr. Nr.285 datë 19.05.2021 “Per miratimin e Rregullave te Prokurimit Publik”, (i perditësuar) Kreu IX, Neni 74

2.3.10 Operatori ekonomik te paraqes nje vetedeklarim ne rast se shpallet i sukseshem ,do te beje regjistrimin e materialeve te mjekimit per te cilat eshte shpallur i sukseshem ne Regjistrin kombetar te pajisjeve Mjekesore prane Agjensise Kombetare te Barnave dhe Pajisjeve mjekesore ne perputhje me nenin 13 te Ligjit 89/2014 i ndryshuar me ligjin 21/2020 date 5.3.2020

Argumentimi: Ky kriter i përcaktuar në pikën c) është vendosur ne perputhje me piken 1 te nenit 79 te Ligjit nr.162, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik”, në të cilën gjejmë të përcaktuar se: *1. Autoriteti ose enti kontraktor për të vërtetuar se punët, mallrat ose shërbimet, objekt prokurimi, i plotësojnë kërkesat e cilësisë, mund t’u kërkojë ofertuesve të paraqesin certifikata të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë.Kjo dispozitë zbatohet edhe kur kërkesat teknike u referohen kualifikimeve të kandidatit ose të ofertuesit.*

Ky kriter gjen mbështetje ne piken 1 te nenit 44 te VKM nr 285 date 19.05.2021 “Per Miratimin e Rregullave te Prokurimit Publik”, ku percaktohet se: *Autoriteti/enti kontraktor, për të vërtetuar se punët, mallrat ose shërbimet, objekt prokurimi, i plotësojnë kërkesat e cilësisë, mund t’u kërkojë ofertuesve të paraqesin certifikata të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë, vetëm nëse ato janë të argumentuara dhe të lidhura ngushtësisht dhe në mënyrë të drejtpërdrejtë me objektin e prokurimit.*

Kjo kerkese gjen mbështetje edhe ne Ligjin Nr. 21/2020 për disa shtesa dhe ndryshime në Ligjin Nr. 89/2014 “Për Pajisjet Mjekësore”, Neni 13 “Procesi i regjistrimit”, pika 1 parashikon: Të gjitha pajisjet mjekësore, që vendosen në treg në Republikën e Shqipërisë, duhet të regjistrohen në Regjistrin Kombëtar të Pajisjeve Mjekësore, që mbahet nga Agjencia Kombëtare e Barnave dhe Pajisjeve Mjekësore.

2.3.11 Kërkohen të paraqiten mostra për të gjithë artikujt e ofruar.

Dorëzimi i Kampioneve/ mostrave të bëhet pranë Autoriteti Kontraktor, të mbyllura me ngjitëse në zarf/a ose kuti jo transparente të vulosur/a, mbi të cilin/at të shënohet: “Mos e hapni me përjashtim te

rasteve kur është i pranishëm Komisioni i Vlerësimit të Ofertave të procedurës së prokurimit « » dhe jo para datës 15.01.2024, ora 10 :00

- Së bashku me mostrat ofertuesi duhet të japë edhe një shkresë të vulosur dhe firmosur ku të listohen mostrat që ndodhen në zarf/kuti.
- Mbi çdo mostër të dorëzuar, ofertuesi duhet të shënoje Nr. Rendor të Artikullit që përfaqëson sipas formularit të ofertës (shtojca 2).
- Në paketimin e çdo mostre duhet të evidentohet qartë origjina e mallit e cila duhet të përputhet me origjinën e deklaruar nga ofertuesi në formularin e ofertës (Shtojca 2).

Mostrat e dorëzuara duhet të jenë të shoqëruara me listën e inventarizimit dhe të identifikuara sipas Nr. Rendor të formularit të çmimit, e cila dorëzohet vetëm elektronikisht. Nëse ka mungesa mostrash për artikuj të veçantë ose nëse origjina e stampuar mbi mostër nuk përputhet me origjinën e deklaruar nga ofertuesi, atëherë oferta do të quhet jo e rregullt dhe rrjedhimisht do të skualifikohet.

Argumentimi: Ky kriter është vendosur nga ana e Autoritetit Kontraktor me qëllim vërtetimin se operatori ekonomik i plotëson kërkesat minimale në përputhje me nenin 40, pika 6 b) të VKM nr. 285 datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”. ku shprehet rrjedhimisht: 6. Autoriteti/enti kontraktor mund t’u kërkojë operatorëve ekonomikë të dorëzojnë dëshmi, që tregojnë se ata i plotësojnë kërkesat minimale, të përcaktuara në dokumentet e tenderit, si:

- a) mostra të mallit, kur e gjykon se kjo ka rëndësi për vlerësimin e ofertës teknike. Në këtë rast, autoriteti/enti kontraktor duhet të argumentojë kërkesën për mostrat. Mostrat duhet të trajtohen si informacion konfidencial tregtar dhe duhet të jenë në kontroll të autoritetit/entit kontraktor. Në rastin e procedurave të zhvilluara me mjete elektronike, autoriteti ose enti kontraktor përcakton qartë procedurën për dorëzimin e mostrave, duke garantuar aksesin e çdo operatori të interesuar si dhe konfidencialitetin për pjesëmarrjen në proces. Mostrat i kthehen ofertuesit, me kërkesën e tij, brenda 30 (tridhjetë) ditëve pas nënshkrimit të kontratës, me kusht që kontrata në fjalë të mos jetë objekt i shqyrtimit administrativ apo gjyqësor. Në rastin kur procedura e prokurimit anulohet, mostrat i kthehen ofertuesit, me kërkesën e tij, brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga data e marrjes së vendimit përfundimtar të anulimit; dhe/ose

Paraqitja e mostrave i shërben autoritetit kontraktor për të gjykuar më mire mbi përmbushjen e specifikimeve teknike të kërkuara për objektet që prokurohen me qëllim që cilësia e mallit të jetë në përputhje me kërkesat e përcaktuara nga AK.

o CERTIFIKATAT E CILËSISË

- Në rastet e bashkimit të operatorëve ekonomikë, çdo anëtar i grupit duhet të paraqesë certifikatat e kërkuara të cilësisë sipas zërave që merr përsipër të realizojë në akt marrëveshje.

Shënim: KVO rezervon të drejtën e verifikimit të të dhënave të paraqitura nga ofertuesit

Specifikime teknike të përgjithshme:

Loti 1 – Blerje materiale mjekimi per nevoja spitalore

Nr	Artikulli	Specifikime	Njesia
1	Bende 7cm x 4 m	100% pambuk absorbent, dendesia 24x20	Copë
2	Bende 10 cm x 10 m	100% pambuk absorbent, dendesia 24x20	Copë
3	Bende allcie 10cm x 2.7m	Paketimi individual plastik	Copë
4	Bende adesive 10 cm x 15 m	Cope e pathurur poroze, elastike. Ana ngjitese e mbrojtur me leter te shqiteshme	Copë
5	Bende 20 cm x 10 m	100% pambuk absorbent, dendesia 24x20	Copë
6	Bende allcie 15cm x 2.7m	Paketimi individual plastik	Copë
7	Bende 8cm x 5 m	100% pambuk absorbent, dendesia 24x20	Copë
8	Komprese sterile 5cm x 5cm	100% pamb absorbent, dendesia 24x20, 6pala; jo me shume se 5 cope/pako	Copë
9	Komprese sterile 10cm x 10cm	100% pamb absorbent, dendesia 24x20, 12pala; jo me shume se 5 cope/pako	Copë
10	Komprese sterile 10cm x 20cm	100% pamb absorbent, dendesia 24x20, 8pala; jo me shume se 5 cope/pako	Copë
11	Komprese antimikrobiale 10x10cm	E perbere prej materiali absorbues te imprenjuar me polyhexanide / Ag.	Copë
12	Hemostatik kolageni i absorbueshem	Siperfaqe 100-110 cm2, me origjine nga tendinet e kuajve, 2.8 mg/cm2 fibrile kolagjeni ose ekuivalent	Copë
13	Garze abdominale	Garze sterile, e detektueshme nga rrezet-x, 100% pambuk absorbent, me 6 pala, dimensiononi i nje pale 45x45cm, dendesia 28x28, me funde te qepura, me lak lidhes, jo me shume se 5 cope per pako	Copë
14	Garze 91 cm x 100 m	100% pambuk absorbent, dendesia 24x20	m. linear
15	Pambuk kirurgjikal	100% pambuk hidrofil, pakete 100g	Copë
16	Pulla injeksioni	Dimensionet e peraferta: 0.9 cm x 3.8 cm , me garze perthithese ne mes dhe	Copë

		dy anet me ngjites antialergjik	
17	Leukoplast 5cm x 5m	cope 100% pambuk, ngjites me permbajtje oksid zingu	Copë
18	Leukoplast antialergjik 5cm x 5m	cope e padeptueshme mendafshi, me ngjites antialergjik	Copë
19	Sisteme infuzioni	Sistem infuzioni transparente dhe fleksibel e pershtatshme si per shishet edhe per qeset e infuzionit, e pajisur me valvol ajrimi + filter + age , luer luck + bashkuese e gomuar ne forme "Y" ose "flashball" , me PP flow rregullator , 20 pika / 1ml , e paketuar me qese te sterilizuar .	Copë
20	Doreza ekzaminimi (ndare sipas numrit)	Josterile , me latex natyral , me puder , me permasa XS, S, M, L.	Copë
21	Doreza kirurgjikale sterile (ndare sipas numrit)	Doreza kirurgjikale me puder, latex natyral, paketuar ne zarfe letre te sterilizuar me rreze Gama ose gaz Etilen sipas normativave EN; madhesia 6.5, 7, 7.5, 8, 8.5	pale
22	Lama bisturie	Nr: 15, 20, 21, 22, 23, 24	Copë
23	Absorbues CO2 per Anestezi	Permbajtja: Hidroxid Calciumi dhe Natriumi. Granulariteti 3÷5 mm. pH: 12 - 14. Ndryshim ngjyre pas saturimit me CO2.	Kg
24	Maske oksigjeni	me zgjatues L=1.5-2m	Copë
25	Sonde oksigjeni adult	nazale, adult, L=1.5-2 m	Copë
26	Sonde oksigjeni pediatrike	nazale, pediatrike L=1.6+0.6 m, diam .4 mm	Copë
27	Kanjula nazale per CPAP	Per infant, ne permasa te ndryshme dhe tipologji sipas autoritetit kontraktor	Copë
28	Komplet aerosoli me tub zgajtues 1.5m	maske me rezervuar per medikamente	komplet
29	Set drenimi Redon me vakum ne forme fizarmonike 500-800ml Komplet redoni G 12-22	Set=(ballon vakumi+form z fold tub+dren+troakar)	set
30	Dren pleural	Tip trocar me brima anash	Copë
31	Dren silikoni	Ch 16-28, L=50cm, me vrima a neseore i detektueshem nga rrezet X	Copë
32	Dren Kehr	silikon, Ch 10-14-16-18-20	Copë
33	Dren torakal I drejte dhe anguluar	PVC, Ch16-Ch32	Copë

34	Dren abdominal double drain me katere te brendshem		Copë
35	Dren me troakar	Ch12-Ch20	Copë
36	Set steril per funksionim vezike urinare	I perbere nga kateter silikoni me ballon, Ch 10-15 L= 40-70 cm, me introduktor te hapshem	set
37	Maske per terapi CPAP	Madhesi e adoptueshme nga masa S deri ne L	Copë
38	Lageshtues per CPAP	Me tub konektor	Copë
39	Ansa koagulimi	Per resektoskop monopolar 24Fr, me rul sferik	
40	Kateter epidural	kateter 19G/20G+age epidurale+filter	Copë
41	Set epidural	kateter 19G/20G+age epidurale+gide +filter+ shiringe	set
42	Urinokol pediatrik		Copë
43	Kapese kordoni umbilikal		Copë
44	Kateter umbilikal		Copë
45	Tub ushqimi pediatrik	Ch 4, 5. Pediatrik, neonatal. Pa latex/DEHP.	Copë
46	Zhgute		Copë
47	Tuba endotrakeale pediatrike	ID 2 - 5mm, nazal/oral	Copë
48	Tuba endotrakeale adult	ID 5.5mm-8.5mm, nazal/oral, me ballon	Copë
49	Kateter aspirimi pediatrik	Ch 8, 10	Copë
50	Kateter aspirimi adult	Ch 12, 14, 16, 18.	Copë
51	Kateter aspirimi pediatrik me kontroll vakumi	Ch 8, 10	Copë
52	Kateter aspirimi adult me kontroll vakumi	Ch 12, 14, 16, 18.	Copë
53	Maske Laringeale PVC	Maske PVC me nje perdorim. Madhesia Nr.1÷5	Copë
54	Leter printeri ECHO		Copë
55	1-3 kanale		Copë
56	6-12 kanale		Copë
57	Leter printer monitori		Copë
58	Xhel per ECHO	Bidone 5 kg , Xhel - Transonic / Transparent , densiteti - 1/02 gr /ml + nje pistone dhe dy shishe 250 ml boshe , per cdo kater bidona	Copë
59	Xhel per EKG	Bidon 5 kg , Elektro-Xhel / ECG , densiteti - - 1/02 gr /ml + nje pistone dhe dy shishe 250 ml boshe , per cdo	Copë

		kater bidona	
60	Elektroda monitorimi EKG	Elektroda monitorimi njeperdorimeshe	Copë
61	Elektroda EKG neonatale	Elektroda monitorimi njeperdorimeshe per neonate	Copë
62	Elektroda Defibrillatori	Cift elektroda per defibrilator njeperdorimeshe me konektor. Sterile. (modeli i pajisjes do te percaktohet nga autoriteti kontraktor)	set
63	Aparat tensioni	Me manometer	Copë
64	Steto-fonendoskop	Koke e sheshte	Copë
65	Termometer	termometer pacienti	Copë
66	Spatula (druri)	Sterile, e paketuar individualisht	Copë
67	Set per identifikimin e nenes dhe femijes	Me dy pjese per doren e nenes dhe doren e femijes ne ngjyra te dallueshme	set
68	Gojez spirometrike		Copë
69	Set Filter spirometrik antibakterial	Set i perbere nga: filter antibakterial, gojez spirometrike, dhe klipi nasal	Copë
70	Set Elektroda Aurikulare EEG	Cift elektroda aurikolare. Permbajtje Ag dhe konektor 100-150cm.	set
71	Elektrode EEG tip ure	Elektrode ure per EEG	Copë
72	Sensor oksimetrie neonatal	Per monitor pacienti; set njeperdorimesh neonatal me sensor oksimetrie dhe kabllin perkates	Copë
73	Mansheta monitorimi TA	Per monitore pacienti. Shumeperdorimesh	Copë
74	Aparat Transfuzioni gjaku		cope

Loti 2 – Blerje materiale mjekimi konsumi dhe kirurgjikale per nevoja spitalore

1	Kanjule intravenoze	18G , me valvol	Copë
2	Kanjule intravenoze	20G , me valvol	Copë
3	Kanjule intravenoze	22G , me valvol	Copë
4	Kanjule intravenoze	24G, me valvol	Copë
5	Age mielogramme me doreze	Tip troakar, 16-18G, L=75-90 cm, me doreze regjistruese	Copë
6	Age spinale atraumatike	Pencil point; 22G - 26G; L=7-9cm	Copë
7	Kateter zgjatues venoz	Zgjatues 120-150cm	Copë
8	Ventil tre-rrugesh		Copë
9	Ventil tre-rrugesh me zgjatues	Tub 10-25 cm gjatesi	Copë

10	Kateter urinar Nelaton	Fr 08-20, male	Copë
11	Kateter Foley 2-rruge	Silikon Foley Ped-adult 2-rruge 12G-20G	Copë
12	Kateter Foley 3-rruge	Silikon Foley Ped-adult 3-rruge	Copë
13	Kateter gastro-duodenal	Mono lumen	Copë
14	Sonde gastrike		Copë
15	Sonde rektale		Copë
16	Sonde rektale pediatrike		Copë
17	Qese urine	2000ml, me valvol	Copë
18	Qese urine pediatrike	jo më shumë se 1000ml, me valvol	Copë
19	Age spinale pediatrike		Copë
20	Kanjule trakestomie	4, 4.5, 5.5, 6 mm me ballon	Copë
21	Kanjule trakeostomie 100% silikon	7,7.5,8,8.5 mm me ballon	Copë
22	Kateter urinar	2 rruges, 16 ch, balon 30 -50 ml	Copë
23	Kateter urinar	3 rruges 12-20 ch, balon 30-50 ml	Copë
24	Sfungjer Nazal pa fill, epistaksis	Me perberje polivinil acetat i hidroksilizuar, kompresim i dyfisht, pa fibra, me absorbim te larte, hemostatik dhe biokompatibel, me permasa: Gjatesi 10 cm, gjeresi 1.5 cm dhe lartesi 2.5 cm	Copë
25	Sfungjer Nazal pa fill me tub ajrimi	Me perberje polivinil acetat i hidroksilizuar, kompresim i dyfisht, me absorbim te larte, hemostatik dhe biokompatibel, me permasa: Gjatesi 8cm, trashesi 1.5 cm dhe lartesi 3 cm	Copë
26	Sfungjer Nazal me fill	Me perberje polivinil acetat i hidroksilizuar, kompresim i dyfisht, me absorbim te larte, hemostatik dhe biokompatibel, me permasa: Gjatesi 8cm, gjeresi 1.5 cm dhe lartesi 2 cm	Copë
27	Splint Intranazal Silikoni	Splint Intranazal Silikoni me tub ajrimi	Copë
28	Shiringa 20cc	Shiringe nje perdorimeshe , sterile , me Age 20 G , 3 pjese,	Copë
29	Shiringa 10cc	Shiringe nje perdorimeshe , sterile , me Age 21 G , 3 pjese,	Copë
30	Shiringa 5cc	Shiringe nje perdorimeshe , sterile , me Age 22 G , 3 pjese,	Copë
31	Shiringa 2cc	Shiringe nje perdorimeshe , sterile , me Age 23G , 3 pjese,	Copë
32	Shiringa insuline	Sterile, tre pjeseshe, me Age 26G	Copë
33	Age 21G	sterile	Copë
34	Age 23G	sterile	Copë

35	Age 25G	sterile	Copë
36	Age flutur 24G	sterile	Copë
37	Beze kirurgjikale aktive 7.5 cm x 7.5 cm	Cope e thurur, me thithje te shpejte per plage, me perberes polyakrylate (SAP) me veshje celuloze and solucion ringer, 7.5 cm x 7.5 cm ose ekuivalent	Copë
38	Beze me vazeline	Beze me pomade te thjeshte (vazeline te bardhe, estere acid yndyror digliceroli te karbonateve dhe bikarbonateve, dyll sintetik) e pershkueshme nga ajri dhe eksudati, me shtrese te trashe qe nuk fshihet dhe ne rast te eksudatit masiv, jo alergjike, efektive dhe per trajtim afatgjate. 7.5cm x10 cm ose ekuivalent	Copë
39	Beze hidroxhel	Beze e sfungjerte hidropolimere, hidroxheli me perberje poliure/poliuretan-poliuretan polimer, propilen glikol, me buze adezive poliakrilat. Permasa 15x15 cm;	Copë
40	Silk -USP 1, Gjatesia fijes 70-90cm; dimesnioni i ageve 40-50	me age 1/2 rrethore	Copë
41	Silk -USP 0, Gjatesia fijes 70-90cm; dimesnioni i ageve 40-50	me age 1/2 rrethore	Copë
42	Silk -USP 2-0, Gjatesia fijes 70-90cm; dimesnioni i ageve 30-35	me age 1/2 rrethore	Copë
43	Silk -USP3-0, Gjatesia fijes 70-90cm; dimesnioni i ageve 20-25	age 1/2 rrethore	Copë
44	Silk -USP4-0, Gjatesia fijes 70-90cm; dimesnioni i ageve 20-30	me age 1/2 rrethore shpuese	Copë
45	Silk -USP6-0, Gjatesia fijes 70-90cm; dimesnioni i ageve 16-20	me age 1/2 rrethore prerese	Copë
46	Poliglctin ose PGA , Coated-USP 1; Gjatesia e fijes 70-90 cm; Dimensioni i ageve 40-50	me age 1/2 rrethore	Copë
47	Poliglctin ose PGA , Coated-USP 0; Gjatesia e fijes 70-90 cm; Dimensioni i ageve 40-50	me age 1/2 rrethore	Copë

48	Poliglctin ose PGA , Coated-USP 2- 0; Gjatesia e fijes 70-90 cm; Dimensioni i ageve 30-40	me age 1/2 rrethore	Copë
49	Poliglctin ose PGA , Coated-USP 3- 0; Gjatesia e fijes 70-90 cm; Dimensioni i ageve 20-30	me age 1/2 rrethore	Copë
50	Poliglctin ose PGA , Coated-USP 4- 0; Gjatesia e fijes 70-90 cm; Dimensioni i ageve 20-30	me age 1/2 rrethore	Copë
51	Poliglctin ose PGA , Coated-USP5-0, Gjatesia fijes 70-90cm; dimesnioni i ageve 17-22	me age 1/2 rrethore	Copë
52	Polypropylene-USP1, Gjatesia fijes 70-90cm; dimesnioni i ageve 30-40 mm	1/2 rrethore	Copë
53	Polypropylene-USP0, Gjatesia fijes 70-90cm; dimesnioni i ageve 30-40 mm	1/2 rrethore	Copë
54	Polypropylene-USP2-0, Gjatesia fijes 70-90cm; dimesnioni i ageve 25-30 mm	1/2 rrethore	Copë
55	Polypropylene-USP3-0, Gjatesia fijes 70-90cm; dimesnioni i ageve 25-30 mm	1/2 rrethore	Copë
56	Polypropylene-USP4-0, Gjatesia fijes 60-90cm; dimesnioni i ageve 25-30 mm	1/2 rrethore	Copë
57	Monofilament PVDF, e pa absorbueshme; USP 6/0,	0.7 metric, reverse cutting, 12mm 3/8 circle, length 45 cm	Copë
58	Mesh e vogel	Pjeserisht e absorbueshme (90-120 dite) me perberje polipropilen dhe PGA dhe koprolakton (PP/PGACL)Fije monofilament; pesha e meshes < 30 g/m2, siperfaqja jo me pak se 150cm2	Copë
59	Mesh e madhe	Pjeserisht e absorbueshme (90-120 dite) me perberje polipropilen dhe PGA dhe koprolakton (PP/PGACL)Fije monofilament; pesha e meshes < 30 g/m2, siperfaqja jo me pak se 900cm2, porozitet > 75 mikron	Copë
60	MESH PVDF	Mesh me monofilament PVDF per korrjgimim kirurgjikal inkontinences	Copë

		urinare mikse ose nga sforcimi me teknike minimalisht invazive, 0.1 cm x 0.6 cm ose ekuivalent	
61	Polyamide 6 dhe 66- USP 9-0, Gjatesia e fijos 30-45 cm, Dimensioni i ageve 5-8 mm	spatula 1/2ose 3/8 rrethore, double	Copë
62	Elektroda njeperdorimeshe per tiroidektomi	Instrument ne per ngjitjen e eneve te gjakut deri ne/perfshire 7 mm; te jete ne forme gershere; me maje te harkuar; gjatesia totale 18.8 cm; gjatesia e ngjitjes 16.5mm; gjatesia e prerjes 14.7mm	Copë
63	Dezinfektant instrumentash me baze Glutaraldehide-Formaldehide	Per dezinfektimin manual te instrumenteve kirurgjikale, perfshire endoskopet dhe fibroskopet. Te kete efekt baktericid, fungicid, tuberkulocid, antiviral (perfshire HBV/HIV)Te furnizohet si komplet me solucion e pa - aktivizuar dhe aktivizuesin per perzierjen dhe perftimin e solucionit te gatshem per perdorim.Permbajtja: min. 2% glutaraldehide, etj. Te furnizohet si solucion i gatshem per perdorim (max 5 litra / ene). Te kete referenca perdorimi nga firmat e njohura te endoskopeve dhe fibroskopeve	litra
64	Xhel shumeperdorimsh	Per desinfektimin e duarve te personelit mjekesor , Antiseptik i shpejte dhe efektiv, i gatshem per ta perdorur , pa nevojën perdorimin e ujit per shplarje. Te furnizohet ne ene 1 - 3 liter te pajisura me dozator.	litra
65	Peroksid Hidrogjeni 3%	Peroksid hidrogjeni 3% e vellimit . Per perdorim te te plageve te jashteme , i gatshem per ta perdorur	litra
66	Benzalchonium chloride 10%	Benzalchonium chloride 10%. Per dezinfektimin dhe pastrimin e siperfaqeve. Efekt baktericid, mycobaktericid, antiviral.	litra

Përshkrimi i kërkesave të zbatimit të shërbimeve në lidhje me to:

Materialet e mjekimit duhet të përmbushin standartet CE ose CE sipas direktivës MDD/MDR 93/42 EEC. Ato duhet të jenë të markuara CE në momentin e lëvrimit të mallit.

Afati i skadencës: jo më të vogël se 12 muaj nga data e lëvrimit të mallit në destinacion.

Skadencia duhet të jetë e shënuar në ambalazh.

Ambalazhimi të jetë i përshtatshëm sipas llojit të mallit të shoqëruar me etiketat dhe markimin përkatës.

Ofertuesi duhet të përmbushë specifikimet teknike të materialeve mjekësore detyrimisht sipas përcaktimit të bërë në përshkrimin e mallrave në DS të kësaj procedurë prokurimi.

II. Argumentimi i specifikimeve teknike

Në seksionin e specifikimeve teknike, *komisioni* vendosi të njëjtat specifikime teknike dhe sasi e kërkesa të përcaktuara nga hartuesit e specifikimeve teknike të dokumentuara sipas shkresës për përlogaritjen e fondit limit nr 2004 prot date 27.12.2024 të hartuar nga grupi I punës në përputhje me parashikimet e nenit 4, pika 38/b dhe nenit 36, të LPP, si dhe nenit 40, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

Në lidhje me kushtet e veçanta për kualifikim, njësia bazuar në rregullat e prokurimit publik të referueshme, në raport me shumën dhe objektin e prokuruar përcaktoi këto kritere si minimumin e kërkuar për t’u plotësuar nga operatorët ekonomikë.

Njesia e prokurimit, referuar nenit 49 pika 3 të ligjit Nr. 162/2020 datë 23.12.2020 përcaktoi afatet e dorëzimit dhe hapjes të ofertave si me poshtë :

Afati kohor për dorëzimin e ofertave ose kërkesave për pjesëmarrje apo hapjen etyre :

Data: 05.02.2025 Ora: 11:00

Njesia e Prokurimit